USAID FROM THE AMERICAN PEOPLE | LOCAL GOVERNANCE PROGRAM IN ALBANIA

HISTORI SUKSESI

Arrihet rritja e mbledhjes së të ardhurave nga taksat vendore me anë të ndërgjegjësimit më të mirë të funksionit dhe rezultateve të dritares së shërbimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit

Z. Eduart Koca, Inspektor i Tatimeve në Bashkinë e Lezhës, një nga pjesëmarrësit në trajnimin e organizuar nga Programi LGPA për rritjen e përdorimit të informacionit nga Dritaret e Shërbimit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit nga pushteti vendor

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri, i USAID-it, inkurajon dhe lehtëson rritjen e ekonomisë vendore me anë të veprimtarive që rrisin investimet, krijojnë vende të reja pune, rrisin të ardhurat duke sjellë si rezultat rritjen e të ardhurave të bashkive nëpërmjet vjeljes së taksave dhe tatimeve.

"Tani që mësova rreth procedurave të regjistrimit të bizneseve të reja në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, puna ime është bërë shumë herë më e lehtë. Tani e kuptoj më mirë marrëdhënien time me këtë Qendrën dhe kam mësuar të përdor sistemin e saj për të përmirësuar saktësinë e regjistrit tonë vendor të taksave dhe për të rritur vjeljen e taksave vendore," thotë z. Eduart Koca, inspektor tatimesh në Drejtorinë e Taksave në Bashkinë e Lezhës.

Eduarti mori pjesë në trajnimin e organizuar nga Programi LGPA në qershor të vitit 2008 në Lezhë. Trajnimi, i realizuar në bashkëpunim me specialistë të lartë të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), u mësoi inspektorëve tatimorë të pushtetit vendor për mënyrat e përdorimit më të mirë të informacionit të përpiluar nga QKR me qëllim përmirësimin e administrimit të taksave dhe rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat për biznesin vendore. Sistemi i suksesshëm 'one-stop-shop' i QKR-së përfshin regjistrimin e njëkohësishëm tek organet përkatëse tatimore, inspektoriati i punës, si dhe tek instituti i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Trajnimi i QKR-së u organizua në të dhjetë bashkitë partnere të Programit LGPA duke synuar personelin e drejtorive të taksave, të financës dhe drejtorisë juridike të bashkive si dhe nënkryetarët e bashkive që merren më së shumti me këto çështje. Në trajnime morën pjesë gjithsej 86 zyrtarë.

Ndikimi pozitiv i administrimit të përmirësuar të taksave mund të shihet nga shembulli në Lezhë. Dritarja e Shërbimit e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (një nga tre zyrat e financuara nga Programi LGPA) u hap në Lezhë në prill të vitit 2008. Në krahasim me vitin e mëparshëm, regjistrimi i bizneseve të vogla është rritur me 20%. Disa prej këtyre bizneseve ishin të reja, por pjesa me e madhe e tyre ishin biznese ekzistuese që nuk kishin qenë më parë pjesë e ekonomisë 'formale'. Edhe të ardhurat e përftuara nga taksat dhe tarifat janë rritur me 20%, ndërkohë që regjistri vendor i taksave po përditohet dhe po bëhet më i saktë.

Duke u mësuar më shumë për veprimet e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, trajnimi i Programit LGPA u ka mundësuar inspektorëve tatimorë të bashkive të përfitojnë nga të dhënat e regjistrimit të bizneseve që ofron sistemi i QKR-së, duke rritur kështu efektivitetin dhe dobishmërinë e përpjekjeve të tyre për vjeljen e taksave.

Local Governance Program in Albania (LGPA)
St. "Dervish Hima"
3 Towers near "Qemal Stafa" Stadium, Tower No.1, Apt. 91, Tenth Floor
Tirana, Albania
Tel: +355-4-266-637
http://albania.usaid.gov
http://www.lgpa.al